



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ i Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr.55/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare, Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Sfinga sh.p.k" me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-22-6816-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit, me datën 03.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Sfinga sh.p.k" me seli në Prizren, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.01.2023 me numër protokoll 55/2023 për aktivitetin e prokurimit "Sfinga sh.p.k" me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-22-6816-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna e Prizrenit
- ANULOHE**T, njoftimi për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-22-6816-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal i Prizrenit, lënda kthehet në ri-vlerësim.

3. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- Komuna Prizren të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSh. nr. 605/22 të datës 29.07.2022, lidhur me pretendimet e gjykuara për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e Komunës së Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-22-6816-2-1-1.

4.URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- Komuna Prizren, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe operatorin ekonomik OE “Mazreku” shpk- Malishevë lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh. nr. 209/22, datë 14.12.2022, lidhur me pretendimet e gjykuara për aktivitetin e prokurimit me titull “Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e Komunës së Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-22-6816-2-1-1.

5. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Prizrenit, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

6. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet pjesërisht, të njëjtët i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën: 30.01.2023, OE “Sfinga sh.p.k” me seli në Prizren, ka ripërsëritur ankesën në OSHP kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: “Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e Komunës së Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-22-6816-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë prej 36 muajsh, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 180,000.00 €

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e brendshme shqyrtuese të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 20.02. 2023 ka rekomanduar që:

- të aprovohet ankesa e OE ankues, si dhe
- Kjo çështje sipas ekspertit është çështje e gjykuar
-

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit, ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë prej 36 muajsh –shërbim, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës 180,000.00 euro. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe mos zbatim të vendimit të PSH.605/22, të datës 14.12.2022.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) “Sfinga SH.P.K. –Prizren

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se tani kemi të bëjmë me lëndë të përsëritur, ku palët janë të njëjta dhe eksperti shqyrtues përmes raportit paraprak të datës 29.11.2022, me numër 605/22 ka dhënë rekomandimin e tij, ku pretendimet e të njëjtit i ka vlerësuar si pjesërisht të bazuara dhe njëhërit ka rekomanduar të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ndërsa lënda të kthehet në rivlerësim. Kurse, Paneli Shqyrtues me datë 14.12.2022 ka nxjerr vendimin Psh.Nr.605/22 duke e aprovuar ankesën e operatorit ekonomik si të bazuar dhe ka anuluar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, ku obligon AK –Komuna e Prizrenit që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Ekspertja shqyrtues sqaron se kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP sipas ankesës së parashtruar me datë 31.10.2022, ku në bazë të kësaj ankese ishte nxjerr raport i ekspertizës me nr. 605/2022. Në raportin e ekspertit i cili e kishte trajtuar lëndën, i njëjti i kishte propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Sfinga SH.P.K. –Prizren të aprovohet si pjesërisht të bazuara dhe kishte rekomanduar të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Andaj, ekspertja shqyrtuese sqaron se Paneli Shqyrtues i ka gjykuar pretendimet e operatorit ekonomik me Vendimin PSH.nr. 605/2022 të datës 14.12.2022 dhe këto pretendime janë “Res Judicata” sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit:

2. Eksperti i njëjtë shqyrtues, teknik ose profesional i prokurimit, nëse konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga paneli shqyrtues, e njofton me shkrim panelin shqyrtues dhe palet ne procedure lidhur me këto pretendime ankimore.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se Paneli Shqyrtues përmes vendimit PSH.Nr. 605/2022 të datës 14.12.2022, ka konstatuar se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të OE ankues lidhur me referenca, përkatësisht me kërkesën e Kapacitetit Teknik dhe profesional, ku ndër të tjera në këtë vendim është konstatuar se OE “Sfinga SH.P.K. –Prizren ka përmbushur kërkesat e njoftimit për kontratë. Për më tepër, referoju pjesës së shkëputur nga vendimi PSH.Nr.605/2022:

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar dhe nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të OE. Operatori ekonomik në këtë rast ka përmbushur kërkesën “Kapaciteti Teknik dhe Profesional” sa i përket realizimit të kontratave në tri vitet e kaluara konform kërkesës në DT/Njoftimin për Kontratë.

Andaj, duke pasur parasysh konstatimin e Panelit Shqyrtues në lidhje me referencat, përkatësisht me kërkesën e Kapacitetit Teknik dhe profesional, ekspertja shqyrtuese konsideron se kjo çështje tanimë është “res judicata” sepse është vendosur në vendimin Psh.Nr.605/2022 të datës 14.12.2022.

Si pretendim ankimor të cilin e ka potencuar OE në ankesë se nuk është respektuar vendimi i Vendimin PSH.nr. 605/2022 të datës 14.12.2022, dhe te merren masa ndaj zyrtarit te prokurimit, ekspertja shqyrtuese sqaron se është në kompetencë të Panelit Shqyrtues të merr apo mos merr masa kundrejt AK-së.

Po ashtu, Operatori ekonomik “Sfinga SH.P.K. –Prizren ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertës tjerë pjesëmarrëse, përkatësisht kundrejt grupit të operatorit ekonomik “Kreshnik Susuri” B.I Radio Televizioni “Besa”; Aprint Grop SHPK, ku i njëjti është eliminuar nga autoriteti kontraktues, si në letrën standarde të datës 11.01.2021. Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në platformën e e-prokurimit, sqaron se nuk ka has në shkresa se grupi i operatorëve ekonomik “Kreshnik Susuri “ B.I Radio Televizioni “Besa” ; Aprint Grop SHPK “Berisha Com” kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK Komuna e Prizrenit, prandaj vet fakti që i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP, është pajtuar me rezultatin e aktivitetit të prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimit paraparak të OSHP-së.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Sfinga sh.p.k” të aprovohet si bazuar, mirëpo gjithmonë mbetet ne dispozicion te Organit Shqyrtues te vendos nëse 1 dite konsiderohet shkelje e vogël apo nëse do te bazohet tek Neni 105 mbi Kompetencat e OSHP-së pika 2.16. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron, se kemi të bëjmë me lëndë të përsëritur, ku palët janë të njëjta ku e njejeta çështje është vendosuar me vendim të OSHP-së 605/22 me datë 14.12.2022, ku pretendimet e të njëjtit i ka vlerësuar si pjesërisht të bazuara duke e aprovuar ankesën e operatorit ekonomik si të bazuar dhe ka anuluar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, po ashtu është obliguar AK –Komuna e Prizrenit që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues thekson faktin se keto pretendime ankimore operatorit ekonomik OE ankues janë shqyrtuar me Vendimin PSH.nr. 605/2022 të datës 14.12.2022, andaj keto pretendime për

panelin shqyrtues janë “Res Judicata” sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit:

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.605/22, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prizrenit që në tërësi të zbatohet vendimi i PSH nr.605/22. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komunën e Prizrenit që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkojë nga KRPP-ja që t'i anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna e Prizrenit në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së Kuvendi Komunal i Prizrenit,
- 1x1 OE “Sfinga sh.p.k” me seli në Prizren
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.